



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË**

Numri i lëndës: 2023:269751

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05626595

K.DH.SH.II.nr.1582/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit NPSH "Allmakes Global Services" me numër identifikues 810252114 me seli ne Gllogoc, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.B. avokat nga Prishtina, ndaj debitorit "Atlantik Group" shpk, me numër unik identifikues 810792095, me seli ne fshatin Preoc Komuna Garaçanicë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles e Parë KPPP.nr.2362/22 dt.25.10.2023, me datën 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit NPSH "Allmakes Global Services" me numër identifikues 810252114 me seli ne Gllogoc, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës– Dhomat e Shkalles e Parë KPPP.nr. 2362/22 dt.25.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës– Dhomat e Shkalles e Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 2362/22 dt.25.10.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit "Atlantik Group" shpk, me numër unik identifikues 810792095 me seli ne fshatin Preoc Komuna Garaçanicë, ndërsa urdhrin përmbartimor P.nr.344/22 dt.12.10.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli ne Prishtinë, e ka anuluar.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rishqyrtim.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NPSH “Allmakes Global Services” me numër identifikues 810252114 me seli ne Glllogoc, me datën 12.10.2022, ka paraqitur propozim për përmbardim ndaj debitorit Atlantik Group” shpk, me numër unik identifikues 810792095 me seli ne fshatin Preoc Komuna Garaçanicë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.22-SHV01-030-681, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-682, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-683, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-684, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-685, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-687, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-688, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-690, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-691, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-692, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-699 . Përmbarduesi Privat Kushtrim Metaj Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbardimor P.nr.344/22 dt.12.10.2022, ka lejuar përmbardimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura ti paguaj shumen prej 7,333.63 euro si dhe shpenzimet për propozimin për përmbardim ne vlerë prej 117 euro si edhe te gjitha shpenzimet e procedurës deri ne përmbardim te plotë.

Kundër urdhrin përmbardimor, debitori me datën 21.10.2022 ka paraqitur prapësim, duke e kontestuar ne tërësi propozimin e kreditorit sepse faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbardimi nuk i janë dorëzuar asnjëherë debitorit po ashtu te njëjtat nuk përmbajnë asnjë element te vlefshmërisë sepse këto fatura janë te parregullta dhe nuk kanë tipare te përmbardueshmërisë ashtu qe nuk plotësojnë asnjë kusht nga nenet 22, 29 dhe 38 i LPP, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin debitorit, ta anuloj urdhrin përmbardimor dhe ta obligoj kreditorin te paguaj shpenzimet e procedurës përmbardimore.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 25.10.2022, me arsyetimin se nuk pajtohet me asnjë konstatim te debitorit ne prapësim pasi kreditori i ka lëshuar faturat te cilat i ka pranuar debitori dhe se këto fatura plotësojnë kushtet e nevojshme qe duhet ti përmbaj një faturë, shton se prapësimi ka për qëllim vetëm prolongimin e procedurës nga debitori, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj te pabazuar prapësimin e debitorit, dhe urdhrin përmbardimor ta lë ne fuqi dhe te obligohen debitorët te paguajnë shpenzimet e procedurës përmbardimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2362/22, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbardimor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata i referohet dispozitave ligjore nga neni 29 par.1 dhe 3, neni 37 te LPP dhe vlerëson se faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbardimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente te besueshme sepse nuk janë te nënshkruara dhe te vulosura nga debitori dhe nuk mund te vërtetohet se te njëjtat janë dorëzuar tek debitori ne mënyrë te rregullt, ashtu qe si te tilla nuk kanë tipare te përmbardueshmërisë ashtu qe si rrjedhojë e kësaj edhe urdhri përmbardimor duhet te anulohet.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura nuk përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Edhe kjo gjykatë vlerëson se faturat nr.22-SHV01-030-681, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-682, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-683, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-684, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-685, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-687, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-688, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-690, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-691, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-692, dt.15.08.2022, nr.22-SHV01-030-699, nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 par.3 të LPP i cili parasheh që *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* e që në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara e as të vulosura nga debitori, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti nga debitori ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se debitori i ka pranuar faturat në mënyrë të rregullt, po ashtu faturat nuk janë lëshuar konform dispozitave ligjore përkatësisht nenit 37 të LPP sepse këto fatura propozimit për përmbartim i janë bashkëngjitur në kopje dhe jo origjinal ose kopje të vërtetuara, ashtu që nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për ekzekutim. Andaj në vlerësim edhe të nenit 43 par.4 të LPP, gjykata e shkallës së dytë vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Kjo gjykatë analizon pretendimet e kreditorit por vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe nga çka vendosur gjykata e shkallës së parë, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara dhe paargumentuara ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përmbaremore konform parimit të rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.1582/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova